



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 6066 Prot

Tiranë, më 09.3.2018

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

Për publikim: **Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën Doganore Hani i Hotit, pranë Degës Doganore Shkodër, Kategoria C3 (2 vende)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën e Magazinimit të Përkohshëm, në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Tiranë, Kategoria C3 (2 vende)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën Doganore Tushemisht, pranë Degës Doganore Qafë-Thanë, Kategoria C3 (1 vend)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Korçë, Kategoria C3 (2 vende)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Sektorin Doganor Ballsh, pranë Degës Doganore Fier, Kategoria C3 (3 vende)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Berat, Kategoria C3 (2 vende)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Kakavijë, Kategoria C3 (1 vende)
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, në Zyrën Doganore Qafë-Botë, pranë Degës Doganore Sarandë, Kategoria C3 (1 vend)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. të kenë shtetësi shqiptare;
2. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;

4. të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. të mos kenë qenë pushuar ndonjëherë më parë nga administrata doganore ose Shërbimi Civil për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. të kenë arsim të mesëm.
7. Të zotërojnë patentën e klasit 'B'

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae(dhe letër motivimi);
3. Diplomë e shkollës së mesme e noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti(do të vihet në dispozicion nga DMBNJ);
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat(do të vihet në dispozicion nga DMBNJ);
8. Raport mjeko-ligjor;
9. Kartë identiteti;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 20 . 03.2018, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda Ikonomi**